



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

# Buletin Informativ

## Janar 2017

NË KËTË NUMËR

## Problemet e biznesit Shqipëri-Kosovë, “flasim shqip, por nuk kuptohemi”

Nga Violeta Shqalsi

Edhe pse flasim një gjuhë, edhe pse jemi një komb, edhe pse synojmë të bëjme politika rajonale të përbashkëta, kjo “frymë” nuk duket se po jep rezultat në fushën ekonomike. Prej vitesh biznesi shqiptar dhe ai kosovar ankohen për burokraci dhe barriera të ndryshme në marrëdhëniet mes tyre, apo më mirë të thuhet me institucionet e të dy vendeve. Shpesh herë përfaqësuesit e biznesit të dy vendeve janë shprehur publikisht që politikanët duhet të lënë mënjëanë “folklorizmat patriotikë” dhe të fokusohen tek politikat e përbashkëta ekonomike.

Unifikimi i praktikave doganore, njohja e certifikatës së origjinës së produkteve, vulave të cilësisë, çmimeve të referencës në mbrojtje të konkurrencës në treg, si dhe njehsimi në fushën e akreditimit, standardizimit dhe metrologjisë, janë vetëm disa nga problematikat që has biznesi cdo ditë.

“Hallet” e tyre janë akoma prezente edhe pse bashkëpunimi ekonomiko-tregtar mes dy vendeve ka qënë objektiv i shume takimeve të përbashkëta, mes Kosovës dhe Tiranës zyrtare, ku janë diskutuar të gjitha problematikat që ka hasur biznesi i të dy vendeve. (vijon f 3)

Thirrje për grante

“Sipermarrjet Kreative 2017”

Projekti “I4TOUR”

Deadline per aplikim 24 shkurt  
2017, ora 14.00

Vlorë-LLogara- Dhërmi

<http://www.ekonomia.gov.al/al/projekte/thirret-calls>

Page 2



## Thirrje për grante

MZHETTS

### Sipermarrjet Kreative 2017

#### Projekti "I4TOUR"

#### Vlorë, Llogara, Dhërmi

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në kuadër të projektit "I4TOUR - Zhvillimi Territorial për Turizmin e Qëndrueshëm, Ndërmarrjet Krijuese, Zhvillimi Rural dhe Punësimi i të Rinjve" i financuar nga IADSA (Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim), çel thirrjen e dytë për dhënien e granteve mbështetëse



për sipërmarrjet kreative të planifikuara për tu ngritur bazuar në ide inovative. Nëse keni një ide kreative në sektorin e turizmit, ju mund ta ktheni atë në një sipërmarrje të mirëfilltë, duke përfituar nga grantet mbështetëse që ofron Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Nëpërmjet kësaj nisme krijohet mundësia më e mirë për të transformuar një ide inovative në një sipërmarrje të mirëfilltë, duke



ofruar një grant mbështetës, ambientet e punës, si dhe një asistencë të kualifikuar për zhvillimin e idesë, ku do të financohen 5 grante, prej 500 mijë Lekë për biznese Start-Up, në sektorin e turizmit, në qarkun e Vlorës. Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë faqen e web-it të projektit I4TOUR, [www.i4tour.info](http://www.i4tour.info), duke shkarkuar formularin e aplikimit si dhe guidën shoqëruese të formularit të aplikimit. Afati kohor për pranimin e aplikimeve është data **24 shkurt 2017**.

**Apliko!**



**Thirrja e parë për projektpropozime në fushën Rrugët Detare për Evropën**

**Programi EUSAIR**

Përmes kësaj thirrje synohet të nxitet diversifikimi i produkteve dhe shërbimeve të turizmit detar evropian nëpërmjet zhvillimit të rrugëve detare dhe produkteve përkatëse; mbështetja e zhvillimit të produkteve turistike trans-nacionale; promovimi i turizmit detar dhe turizmit të sporteve të ujit; krijimi i sinergjive me segmente të tjerë turistikë, si turizmi ushqimor dhe i verës, kulturor etj.; nxitja e bashkëpunimit transnacional mes

aktorëve të ndryshëm në zinxhirin e vlerës së turizmit.

Në kuadër të thirrjes janë parashikuar **1,500,000 Euro** për financimin e projekteve që synojnë krijimin e rrugëve transnacionale që ndërlidhen me atraksionet turistike në zonat bregdetare të vendeve, zhvillimin e një strategjie afatgjatë për rrugën detare, konsultimin me aktorë relevantë për projektimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rrugës detare dhe produkteve që lidhen me të, ngritjen e një mekanizmi për bashkëpunim mes aktorëve të ndryshëm në zinxhirin e vlerës së turizmit.

Afati kohor për pranimin e aplikimeve është data **20 shkurt 2017**.

Për një informacion përmbledhës lidhur me objektin e kësaj thirrje si dhe dokumentacionin e plotë për procedurat e aplikimit dhe financimit të projekteve, lutemi klikoni në:

<https://ec.europa.eu/easme/en/europe-an-maritime-and-fisheries-fund>

**Apliko!**



## Problemet e biznesit Shqipëri - Kosovë

(nga f 1)

-Po të kthehemi pak në retrospektivë, vetëm tre vite më parë nisi një luftë e ftohtë tregtare mes autoriteteve të dy vendeve, duke bllokuar reciprokisht mallrat e ndryshme të bizneseve. Fillimisht autoritetet kosovare vendosën një taksë të lartë doganore për çimenton dhe patatën e prodhuar në Shqipëri. Ndërsa, më pas, në tregun e Kosovës u bllokua një sasi e konsiderueshme e qumështit nga Shqipëria me arsyetimin së përmbante normë të lartë aflatoksine. Ndërkohë që qeveria shqiptare miratoi 3 vjet me parë në parim marrëveshjen kuadër, për bashkëpunimin në lehtësimin e tregtisë, bizneset e të dy vendeve përballëshin me procedura burokratike nga doganat respektive, duke shkaktuar një luftë të ftohtë tregtare mes dy vendeve. Këto vështirësi nxirrnin pretekste për mallra nga më të ndryshmet, si ushqimore, por edhe për materialet e ndërtimit. Gjithashtu autoritetet kosovare përdorën një praktikë të re për të bllokuar eksportet shqiptare, duke goditur kryesisht automjetet transportuese të mallrave nga Shqipëria duhet të ndryshonin destinacionin e tyre nga distributorët apo konsumatorët, drejt terminaleve doganore private në qytetet e Ferizajt, Prishtinës dhe Prizrenit. Kjo

procedurë e re rriti kostot e transportit për firmat shqiptare, si në vlerë monetare, ashtu edhe në kohë, duke mos dorëzuar mallrat në destinacionet finale. Masat e ndërmarra nga qeveria kosovare me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit, sollën demotivimin e bizneseve shqiptare, pasi në терминаlet doganore nuk ka



banka për të kryer veprime financiare dhe kostot e qëndrimit të kamionëve arrijnë në 40 euro dita. Ndërkohë që dëmi i shkaktuar vetëm në sektorin e materialeve të ndërtimit në atë kohë u përllorarit se kapi shifrën e 800 mijë euro në muaj. Ndërkohë që procedurat e njëjta doganore mes dy vendeve ka qenë një kërkesë e kahershme e biznesit, çka do të rriste edhe shkëmbimet tregtare që janë ende në nivele minimale. Hapja e pikës së përbashkët doganore në Vermicë, ishte vetëm hapi i parë i kësaj rruge. Por problematikave të shumta që has biznesi shqiptar dhe ai kosovar në pikat doganore respektive duket se po u vjen fundi. Takime bilaterale të autoriteteve publike të të dy vendeve tona, por dhe bashkërendimi i punës së administratave fiskale duket se po ngushtojnë dallimet që

ekzistojnë në ambientin ekonomik në secilin vend.

Por takime të shumta janë zhvilluar, premtime të mëdha janë bërë për këtë pjesë, ndërsa lehtësitë ndaj biznesit janë të prekshme në nivele modeste. Vetëm para pak kohësh gjatë një takimi mis dy krerëve të Financave të dy vendeve, Ahmetaj-Hoti, u premtua se “*udhëzimi për funksionimin e doganave 24/7 për sipërmarrjet kosovare dhe kalimi përmes korsisë jeshile në doganë për produktet e freskëta të stinës gjatë muajve të verës, ishin nisma të mirëpritura nga bizneset kosovare dhe këtë vit, ndërsa kanali jeshil do të vihet në funksionim që në muajin maj. Nga ana tjetër, Sistemi i Përbashkët i Tranzitit, i finalizuar në dhjetor 2016, përmes ndërlidhjes automatike të sistemeve elektronike, u mundëson tashmë bizneseve nisjen e një procedure tranziti në territorin e Shqipërisë apo të Kosovës dhe mbylljen e tij në vendin tjetër, duke shmangur kontrollet e panevojshme kufitare dhe reduktuar ndjeshëm kohën dhe kostot për sipërmarrjen. Nëse procedura më parë zgjaste me ditë, tani është reduktuar në vetëm 10 minuta*”. Ndërkohë një problem tjetër shumë prezent është njehsimi i certifikatave ndërmjet dy vendeve, si një çështje që duhet avancuar në kuadër të marrëveshjes mes dy vendeve.

## Sipërmarrëse të sukseshme

**Suzana Numani Rama**

Suzana Numani është një prej anëtareve më aktive të Shoqatës së Grave Profesioniste Afariste (SHGPAZ), e cila është jo vetëm një sipërmarrëse e zonja, por edhe një grua e nënë shëmbëllore, një model që duhet të nxisë të rehat shqiptare, një figure që duhet të promovohet.

Suzana ka mbaruar universitetin për gjuhë-letërsi në vitin 1996 dhe ka punuar mësuese e gjuhë-letërsisë në Fier për 3 vite para se t'i lindte ideja për të hapur një shkollë private, që idetë dhe filozofinë që ajo kishte për arsimin, ta ndërtonte në projektin e saj.

Me shtysën e babait dhe me mbështetjen e familjes ajo e mori këtë iniciativë në një kohë kur sektori privat i arsimit ishte akoma në hapat e parë dhe rrethohej me skepticizëm, si çdo gjë e re, si çdo gjë private, për shkak të kulturës së afërt që vendi kishte me kohën e komunizmit, ku ekonomia ishte e centralizuar.

*"Isha shumë e dyshimtë dhe skeptike në fillim. E kisha me shumë pasion, por më dukej e vështirë. Më dukej e vështirë sepse duhet të bëja shumë gjëra ndryshe nga shteti me qëllim që njerëzit t'i sillnin fëmijët e tyre tek ti, të të besonin ty dhe të shikonin diferencën mes shkollës private dhe asaj shtetërore. Pra duhej të siguroja infrastrukturën, stafin*

*shumë të mirë, të punoja me pasion dhe përkushtim"*.

Ajo beson se sot e ka fituar sfidën. Para 17 vitesh e ka nisur me ambiente me qira dhe sot ka arritur një investim në godina të mëdha, që rrethohen me ambiente sportive dhe gjelbërim në një hapësirë rreth 4 mijë metra katrorë.



*"Ky sukses vjen falë besimit të prindërve që kanë parë ndryshimin dhe suksesin e fëmijëve të tyre në shkollimin e tyre tek Numani"* thotë Suzana.

Pa pasur asnjë përvojë në menaxhim të një biznesi, ajo thotë se fillimisht i besoi intuitës dhe përvojës që kishte në arsim.

*"Familja ime mbas viteve '90 morën një dyqan dhe merreshin me një lloj tregtie por gjithsesi në fillim ishte gjithçka intuitive. Kam ecur në këtë mënyrë, pastaj sigurisht që e plotësova karrierën time dhe me edukim. Bëra një kurs 2-vjeçar në menaxhim, pastaj nisa masterin në UET. Më vlejti shumë eksperiencia në UET pasi aty pashë pedagogë*

*shumë të mirë, gjë që e lidha dhe me punën time. Fillova të bëja dhe paralelizmin, se si funksionon një universitet, më vlejti shumë mënyra e organizimit, e zgjedhjes së pedagogëve shumë të mirë etj"*.

### Të formosh qytetarin e ardhshëm të vendit

Ka pasur raste që Suzana Numani ka ndjekur ecurinë dhe rritjen e një fëmije që nga mosha 3 vjeç, në kopsht, deri në maturë, në moshën 18 vjeç dhe për të kjo është nga ato kënaqësitë e rralla.

Sot nxënësit që kanë mbaruar gjimnazin të Numani, ku ajo ka dhe vajzën e saj në maturë, kanë shkëlqyer në karrierë, kanë vijuar studimet jashtë Shqipërisë ose kanë hapur bizneset e tyre private. Po cila është filozofia e saj e arsimit?

*"Ne punojmë që të përgatisim njerëz të aftë, jo vetëm shkencërisht, por në radhë të parë njerëz me vlera. Besoj se në atë oqean të madh, ne numërojmë 1 mijë nxënës, kam ndikuar mbase pak, por them se kam ndikuar pozitivisht"*, thotë ajo.


**Ajo është shpallur fituese e Çmimit të Karrierës së UET-Alumni për vitin 2016.**



## Informacion rreth markës

### Çfarë është një markë tregtare apo shërbimi?

Marka është një fjalë, simbol, vizatim, apo kombinim i fjalëve, i frazave, simboleve apo vizatimeve që identifikojnë dhe dallojnë burimin e mallrave të një pale nga ato të një pale tjetër. Përkufizimi i markës së shërbimit është i njëjtë me atë të markës tregtare, me përjashtim që ato identifikojnë dhe dallojnë burimin e shërbimeve dhe jo produktet.



### Shënjat që përbëjnë markë

- Fjalët, kombinimet e fjalëve, duke përfshirë dhe emrat personal
- Gërmat, numrat,
- Shënjat figurative duke përfshirë vizatimet
- Format tridimensionale, duke përfshirë format e mallrave dhe amballazhet e tyre.
- Ngjyrat, kombinimin e ngjyrave, sinjalet e dritës në



qoftë se ato paraqiten grafikiisht,

- Kombinimi i shenjave të përmendura më lart.



### Shenjat që nuk përbëjnë markë

Jo çdo simbol mund të mbrohet si markë, pra ligji lejon mundësinë e refuzimit të regjistrimit të markës në qoftë se:

- Marka e depozituar mund të jetë në kundërshtim me rregullat e moralit publik.
- Marka e depozituar konsiston në emblema shtetërore ose të organizatave ndërkombëtare, flamurë, simbole fetare.
- Markat të cilat konsistojnë në emrat e personave të mirënjohur nga publiku, portretet ose pseudonimet e tyre, pa autorizimin e këtyre personave.

Nga ana tjetër, fakti që marka tregtare është regjistruar në Rregjistrin e markave tregtare, nuk bën pjesë në shkaqet e refuzimit të një kërkesë për regjistrim. Kjo bën pjesë në të drejtën e pronarit të mëparshëm të markës që të vendosë nëse do të lejojë ose kundërshtojë regjistrimin e saj.

Tarifat për regjistrimin e Markës

- tarifa për lëshimin e ekstraktit të regjistrimit për markat **500 lek**
- tarifa për kryerjen e hetimit për një markë **500 lek**
- tarifa për lëshimin e dublikatave të certifikatave të regjistrimit, të certifikatave të ripërtëritjes.



## FAKTE

31.3%

Biznese aktive të drejtuara/pronare gra, për vitin 2015 në Shqipëri.



## Takim në Shkodër



95%

E bizneseve të vogla e të mesme me mbi 10 të punësuar përdorin kompiuter për qëllime pune për vitin 2015. Po bizneset familjare (mikro)???



Më 12 janar u zhvillua takimi në Shkodër, për rolin që luan Shoqëria Civile e sidomos Shoqata e Gruas Profesioniste, Afariste dhe Zejtare Dega Shkodër. U prezantua Dokumenti I Raportit vjetor të Degës Shkodër. Shoqata ndihmon sipërmarrëset gra në fushat e trajnimit, b2b, etj.



# Gruaja dhe shëndeti

## Kanceri i zorrës së trashë

Materiale të përpunuara nga Arlinda Demeti

**Kanceri i zorrës së trashë** është një ndër problemet më të rënda me të cilat përballet aparati tretës në organizmin e njeriut. Është sëmundja e tretë më e diagnostikuar ndër sëmundjet tumorale në mbarë botën, me incidencë me më shumë se 1 milion të prekur të rinj në vit, ndërsa vdekshmëria llogaritet në më shumë se 500 mijë raste. Kanceri kolateral llogaritet i dyti në listën e tumoreve për sa i përket vdekshmërisë në të dy sekset. Risku për kancerin e zorrës varion nga njeri vend në tjetrin, si dhe nga një individ në tjetrin. Varet nga faktorë trashëgimisë, gjenetikë, stili i jetës, dieta, konsumi i duhanit etj. Ndërsa kanceri anal përbën rreth 4% të rasteve të diagnostikuara me kancer të zorrës së trashë.



**Çfarë është kancer të zorrës së trashë?** Kanceri është formacion tumoral me qeliza atipike që rritet në paretin e zorrës së trashë dhe duke u zhvilluar prek gradualisht gjithë murin e saj dhe përhapet si lokalisht edhe në distancë në organe të tjera të trupit.

**Faktorët e riskut:** Moshë mbi 50 vjeç, konsumi i tepruar i yndyrave, i mishit të kuq, alkoolit, obeziteti, pirja e duhanit etj. Ata që kanë një histori familjare me kancer të zorrës së trashë janë 2-3 herë më të predispozuar që të zhvillojnë kancer se personat pa histori familjare.

**Simptomat:** Hemorragji nga zorra; dhimbje e fryrje të barkut; ulje të oreksit dhe rënie në peshë, të vjella, lodhje trupore, dhimbje anale.

**Diagnostikimi:** kolonoskopi biopsi e formacionit të gjetur në zorrën e trashë. Imazheri e avancuar si skaneri, PET, rezonanca magnetike torako-abdomino-pelvike për të parë shtrirjen e sëmundjes dhe për të bërë ndarjen në stade të saj.

**Trajtimi:** sipas protokollit trajtim kirurgjikal + kimioterapi + radioterapi.

**Masat parandaluese:**

Është mjaft e rëndësishme nëse rritet mbikëqyrja në mënyrën e të ushqyerit në konsumimin e drithërave, perimeve, frutave dhe reduktimin e mishit të kuq.

Disa ushqime mund të kontribuojnë në zhvillimin e kancerit të zorrës së trashë; disa të tjera mund të ulin rrezikun e tij. Për ata që kanë predispozitë

gjenetike për kancerin e kolonës është domosdoshmëri përzgjedhja e ushqimeve që duhet të konsumojnë!

**Një regjim ushqimor me pak yndyrë dhe sa me pak yndyra shtazore të ngopura!** Janë dy mënyra sesi yndyrat e ushqimit ndikojnë në zhvillimin e kancerit. E para, që të zhvillohen qelizat tumorale nevojiten lipoproteina të densitetit të ulët (LDL-kolesteroli i keq!). Kështu, një dietë që ndikon në uljen e LDL-se ndikon edhe në uljen e rritjes së qelizave kanceroze. Konsumi i yndyrave gjithashtu rrit prodhimin e lëngut tretës të mëlçisë. Nëse prodhohet me shumicë, ky lëng qëndron më gjatë në zorrën e trashë dhe kthehet në acid apkolik, një kancerogjen i provuar.

Këshillohet që jo më shumë se 30% e kalorive ditore duhet të vijnë nga yndyrat. Kjo do të thotë se nëse nevojiteni 2500kalori në ditë, sasia e yndyrave nuk duhet të jetë më shumë se 70gr. Konsumi i yndyrave të gabuara është shumë më keq sesa konsumi i tepërt i yndyrave. Yndyrat e pangopura të nevojshme për t'u përdorur gjenden në ushqime bimore si: **fara, perime dhe fasule, vaji i ullirit, vaji i linit, farave të rrushit, farave të kërpit, arrave dhe avokados.**

Vaji i peshkut si sardeleve, salmonit, tonit. Edhe suplementët cilësorë me yndyra omega 3 janë një alternative parandaluese sidomos për kancerin e zorrës së trashë! Farat e linit përmbajnë dy përbërës të

fuqishëm: acide lyrorë omega 3 dhe fibrat "Lignans". Të dyja bashke ulin rrezikun e kancerit të zorrës së trashë dhe kancerit të gjirit. Nga ky aspekt, farat janë më të preferuara sesa vaji i linit!

**Kujdes: Evitoni yndyrat e hidrogjenizuar si margarinat vegjetale, si dhe vajrat bimor të farërave, sojës, palmës, sepse ato janë potencialisht kancerogjene!**

Dieta e pasur ne fibra është veçanërisht e dobishme për personat që kanë predispozitë gjenetike të kancerit të kolonës. Fibrat kanë disa efekte pozitive: ato përpunohen nga flora bakteriale dhe prodhojnë substanca mbrojtëse, ato ngjisin në vetvete substancat kanceroze dhe i largojnë nëpërmjet jashtëqitjes duke mos i lënë gjatë në kontakt me qelizat intestinale, ato ulin toksicitetin e lëngut të

mëlçisë si dhe ato ulin përqendrimin e estrogjenit në hapësirën e aparatit tretës. Burimet më të mira të fibrave: Qiqrat, fasulet e zeza, fasulet pllaqi; brokoli; lëvorja e grurit, e tërshërës;

Perime anti-kancer: brokoli, lakër, karota, lulëlakër, patëllxhan, mashurka, qepë (të kuqe), specat, radikio, patate e ëmbël, domate, kungull i verdhë; spinaqi; hudhurat, preshi;

Fruta anti-kancer: kajsi, boronica, qitro (të kuq), rrush, limona, portokalle, pjeshke, hurma, luleshtrydhe, mandarina, pjepër

**Këshillë: Konsumoni një mollë në ditë me lëkurë! Pektina që gjendet te lëkura e mollës fermentohet në zorrë dhe prodhon acide lyrore që eliminojnë baktere patogjene. Ato ushqejnë muret e zorrës**

**duke i bërë ato më të forta ndaj toksinave.**

Seleniumi: Ky mineral është i çmuar për të mbrojtur qelizat nga efektet kanceroze të radikaleve të lira. Personat që kanë nivele të ulta të Seleniumit në gjak shfaqin më shpesh polipa të kolonës. Ai është me i efektshëm kur kombinohet me vitamine E. Burim i seleniumit janë: Orizi kaf, gjiza, mishi i qengjit, farat e lulediellit, arrat e Brazilit mishi i pulës dhe hudhra!

**Kujdes: Alkooli e rrit lehtë rrezikun e kancerit të zorrës së trashë dhe lloji që lidhet më shumë është birra! Ajo përmban nitrozamina, një kancerogjen që aktivizohet në zorrë.**

**Këshillë: Gratë mbi 50 vjeç duhet të bëjnë kontrollin e kolonoskopisë**

## Gra të shquara

### Elena Lucrezia Peshkopia

#### Gruaja e parë në botë doktore në filozofi



Elena është gruaja e parë në botë që ka marrë titullin e doktoraturës në filozofi. Ajo ishte gruaja më e arsimuar në Evropë në shekullin e XVII. Për këto vlera e arritje, statuja e Elenës gjendet në Universitetin e Padovës, në një nga universitetet më të vjetra dhe më të njohura të Evropës.

Gjithashtu portreti i saj duke mbrojtur tezën mbi Aristotelin, e vendosur në një kornizë xhami prej 6.6 m, është vendosur në Bibliotekën Frederick Ferris Thomson Memorial në Kolegjin Vassar në Nju Jork (SHBA).

Elena lindi në Venecia në 1646. Ajo ka përfunduar Shkollën Santa Maria dhe San Gallo Albanesi në Venecia, një shkollë me edukim të hershëm tradicional në Republikën e Venedikut (Republika e Shën Markut).

Shkolla u themelua nga shqiptarë të arsimuar dhe fisnikë shqiptarë më 22 tetor 1442, dhe ajo ka vazhduar të jetë djepi i arsimimit



të shqiptarëve deri në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë. Që nga fillimi, djemtë dhe vajzat e kanë ndjekur shkollën së bashku. Mbrojtës të shkollës ishin Zoja e Këshillit të Mirë, si dhe St. Gall, gjithashtu, që nga viti 1447 ishte St. Maurice. Shkolla mbështetej nga taksat që paguanin shqiptarët, ku edhe gratë ishin përfshirë si në detyrimet, ashtu edhe në përfitimet që ofroheshin.

Shqiptari Viktor Karpaçi (Vittore Carpaccio), një artist piktor i shquar European, mbikëqyri ndërtimin e ndërtesës dhe dekorimin e fasadave e shkollës, ndërsa pikturat që ai bëri për

shkollën sot gjenden në galeritë e Venedikut, Milanos, Paris (Louvre), Vjenës, Londër dhe gjetkë.

Prania e madhe e shqiptarëve në Republikën e Venedikut është e lidhur me ndryshimin e vendbanimeve të shqiptarëve, si pasojë e pushtimit Osman. Gjatë shekujve katërmëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë, shqiptarët u shpërngulën drejt Perëndimit dhe u vendosën në Sicili, në jug të Italisë si dhe në Dalmaci.

Elena, duke qenë një muzikante e talentuar dhe një poliglote, vazhdoi studimet në filozofi dhe astronomi, si dhe ndoqi

programin e doktoraturës në filozofi në Universitetin e Padovës. Ajo mbrojti tezën e doktoraturës më 25 qershor 1678 para profesorëve të filozofisë e logjikës, të mjekësisë e të teologjisë. Ajo u bë një lektore e matematikë në Universitetin e Padovës, ku shërbeu deri në vdekjen e saj. Ajo vdiq nga tuberkulozi më 26 korrik 1684 në moshën 38 dhe e varrosën në Kapelën e Shën Lukës, i quajtur në 1978 Capella Cornaro.

(<http://www.gentlewomen.al/2016/08/28/elena-lucrezia-peshkopia-first-female-doctor-of-philosophy-in-the-world/> )

## Buletin Informativ

Janar 2017



Rr.Mujo Ulqinaku,  
Pall.Kristian Konstruktion,  
kati 1, ap.9 Tirana-Albania  
phone/fax:00355 4 2235726  
mob.0682763344, 0692572423  
[info.shgpaz@yahoo.com](mailto:info.shgpaz@yahoo.com)

Pergatiti  
Msc. Flutura XHABIJA &  
Redaksia